

Workshopi i III EUROSAT, për projektin DEA SG2, zhvilluar pranë Gjykatës së Llogarive të Spanjës

Workshop-i i III-të i EUROSAT-t për projektin DEA, u zhvillua në datat 9 - 10 shkurt 2023 pranë Gjykatës së Llogarive të Spanjës. Në këtë workshop morën pjesë përfaqësues të institucioneve homologe të KLSH-së, përkatësisht Suedi, Norvegji, Austri, Bullgari, Danimarkë, Estoni, Kazakistan, Lituani, Poloni, Rumani, Spanjë, Hollandë, Turqi.

Gjatë ditës së parë, u trajtua aspekti teorik i DEA (Data Envelopment Analysis) dhe aplikimi i kësaj metode në kërkim, e cila konsistonte në një metodë matematikore që përdor teknika të programit linear për transformimin në mënyrë efektive të input-eve në output-e, me qëllim vlerësimin e performancës së njësive të ndryshme.



Në vijim, u analizua se si DEA ishte implementuar me sukses në auditimin e performancës pranë institucioneve të edukimit pasuniversitar në Suedi dhe në gjykatat në Norvegji. Në vijim, u prezantua programi i krijuar nga SAI i Norvegjisë, i emërtuar PioneeR. Ky program ka për qëllim përpunimin e të dhënave statistikore dhe paraqitjen e tyre në formë grafike. Aplikimi i kësaj metode në auditim konsiderohet si një kontribut mjaft i çmuar për menaxhimin e gjykatave në Norvegji. Përfundimet e arritura nga DEA ishin përdorur në vijim për menaxhimin e administratës së gjykatave, si dhe gjithashtu janë në proces për normimin e kësaj metode dhe përdorimin e PioneeR, me qëllim ndikimin në mirëqeverisje.

Gjatë ditës së dytë, u dhanë disa këshilla praktike mbi implementimin e DEA-së në auditim. Gjithashtu, u praktikua programi PioneeR në mënyrë individuale dhe u analizuan përfundimet e arritura nga përdorimi i këtij programi. Për praktikimin e këtij programi, u vendos në dispozicion të pjesëmarrësve, database me të dhënat e përdorura për auditimin në gjykatat në Norvegji.